



URDHËR

Nr. 80, datë 15.5.2024

PËR

PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES, DETYRAVE DHE MASËS SË SHPËRBLIMIT TË GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS, SI NJË PLATFORMË KATËRPALËSHE PËR SEKTORIN E LËNDËVE TË PARA

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 5, të kreut I, të vendimit nr.697, datë 6.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT RawMaterials Regional Innovation Center*)”,

URDHËR OJ:

1. Grupi ndërinstitucional i punës, si një platformë katërpalëshe për sektorin e lëndëve të para, me përfaqësues nga institucionet shtetërore përkatëse, shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në industri, bota akademike dhe shoqëria civile të ketë në përbërje këta anëtarë:
 - a) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin minerar;
 - b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën;
 - c) Një përfaqësues nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe klimën e biznesit;
 - ç) Një përfaqësues nga Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para;
 - d) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
 - dh) Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH);

- e) Drejtorin e Albeitit;
 - ë) Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës;
 - f) Një përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologji- Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës;
 - g) Një përfaqësues nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë;
 - gj) Një përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
 - h) Një përfaqësues nga Bashkimi i Prodhuesve të Industrisë Minerare.
2. Grupi ndërinstitational i punës të drejtohet nga kryetari i tij, i cili zgjidhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e tij të parë.
 3. Grupi ndërinstitational i punës të mblidhet me propozimin e kryetarit. Mbledhja e parë e këtij grupi thirret nga drejtori i Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (në vijim Qendra).
 4. Grupi ndërinstitational i punës të rishikojë rregullisht (2-4 herë/vit) aktivitetet kryesore dhe objektivat e Qendrës, si dhe të monitorojë progresin e saj e të japë sugjerime për maksimizimin e zbatimit të planit e të aktiviteteve të Qendrës.
5. Grupi ndërinstitational i punës ka për detyrë:


- a) të nxisë bashkërendimin në nivel të lartë të institucioneve/aktorëve të platformës katërpalëshe (qeverisje qendrore dhe vendore, akademi, biznes dhe shoqëri civile), me qëllim orientimin e punës dhe përcaktimin e prioriteteve të Qendrës, në përputhje me objektivat e qeverisë, si dhe iniciativat e aktet e BE-së;
- b) të propozojë iniciativa dhe të sigurojë hartimin e prioriteteve e të planit të masave për t'u përfshirë në planin e punës së Qendrës për vitin pasardhës, nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës me gjithë aktorët e sektorit;
- c) të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë veprimtarinë me drejtorin e Qendrës;
- ç) të rekomandojë masat e nevojshme dhe të orientojë punën organizative për nisma dhe iniciativa të tjera që lidhen me sektorin e lëndëve të para minerare;
- d) të diskutojë dhe të propozojë ndryshime të kuadrit rregulator apo masa të tjera që ndihmojnë në modernizimin e sektorit dhe që janë në linjë me objektivat e BE-së;
- dh) të shërbejë si një forum diskutimi për sektorin e lëndëve të para minerare mes aktorëve të platformës katërpalëshe;
- e) të mbështesë Qendrën në realizimin e objektivave të saj;

- ë) të mbështesë zbatimin e planit vjetor të veprimit të Qendrës, organizimin e punës, koordinimin dhe menaxhimin e saj;
 - f) të propozojë grupet përkatëse të interesit, partnerët potencialë si dhe pjesëmarrësit për aktivitetet që Qendra organizon;
 - g) të sugjerojë opsione për financime të ndryshme që lidhen me aktivitetet dhe projektet për sektorin e lëndëve të para.
6. Institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, të zëvendësojnë përfaqësuesit e tyre në rast se mungojnë pa arsyë në më shumë se dy mbledhje të njëpasnjëshme.
7. Mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës të zhvillohen kur merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Në këto mbledhje, sipas pikave të agjendës, mund të ftohen të marrin pjesë ekspertë dhe teknikë të jashtëm të interesuar ose nga institucione të tjera që nuk janë pjesë e këtij grupei pune.
8. Grupi ndërinstitucional i punës të mblidhet, si rregull, jo më pak se 2 (dy) herë në vit dhe sa herë kërkonit nga kryetari i saj apo drejtori i Qendrës.
9. Grupi ndërinstitucional i punës të bashkëpunojë me drejtorin e Qendrës dhe t'i raportojë ministrit përgjegjës për industrinë një herë në vit në lidhje me securinë e Qendrës dhe aktivitetin e grupit të punës, si dhe të marrë miratimin e tij paraprak për dokumentet/produktet e përgatitura.
10. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës është përgjegjës për komunikimet me palët e treta, organizimin e punës dhe funksionimin e grupit të punës.
11. GNP-ja, me qëllim përbushjen e detyrave, të mbështetet nga një sekretariat teknik. Roli i sekretariatit teknik të kryhet nga Qendra Rajonale e Inovacionit e Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para.
12. Sekretariati teknik ka për detyrë:
- a) të sigurojë mbështetje teknike për menaxhimin e procesit përfunksionimin e GNP-së;
 - b) të koordinojë punën ndërmjet anëtarëve të GNP-së, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon gjithsecili;
 - c) të organizojë mbledhjet e GNP-së dhe të paraqesë çështjet për diskutim, të përgatitura në bashkëpunim me anëtarët e GNP-së;
 - ç) të kryejë çdo detyrë tjeter që i ngarkohet nga kryetari i GNP-së.
13. Anëtarët e GNP-së shpërblehen, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe kryetari në masën 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë. Shpërblimi jepet për çdo

mbledhje të kryer. Në rast se brenda një muaj kryhen dy ose më shumë mbledhje, anëtarët dhe kryetari shpërblehen vetëm për një mbledhje.

14. Efektet financiare, sipas pikës 14, të këtij urdhri, të mbulohen nga buxheti i Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para.
15. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të përcjellin emrin dhe kontaktet e përfaqësuesit të tyre pranë Qendrës, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
16. Ngarkohen anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës dhe drejtori i Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



NR.PROT.1619/2
DATË 15.5.2024

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE
KLIMËN E BIZNESIT
QENDRËS RAJONALE TË INOVACIONIT TË
INSTITUTIT EVROPIAN TË TEKNOLOGJISË DHE
INOVACIONIT PËR LËNDËT E PARA
AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE
SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR
ALBEITIT
AGJENCISË SË INOVACIONIT DHE EKSELENCEΣ
FAKULTETIT TË GJEOLOGJI- MINIERAVE
BASHKIMIT TË PRODHUESVE SHQIPTARË
BASHKIMIT TË DHOMAVE TË TREGTISË DHE
INDUSTRISË
BASHKIMIT TË PRODHUESVE TË INDUSTRISË
MINERARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

